

PËRGATITJA E PLANIT TË KONSULTIMIT

1. Emri i ligjit/politikës të propozuar:

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore, 2023-2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve”

Audienca e synuar, lloji i konsultimeve (paraprake/k. për projekt-ligjet), metodat e konsultimit, kanali i komunikimit për shkëmbimin e informacionit

Audienca e synuar	Lloji i konsultimeve: (1) konsultime paraprake, (2) konsultime për projekt-ligjit	Metodat e konsultimit (<i>e-konsultimi, takimet publike, etj.</i>)	Kanali i komunikimit për shkëmbimin e informacionit dhe ftesave (<i>e-mail, rrjetet sociale, etj.</i>)
Publiku Qytetarë, Çdo përfaqësues tjetër të publikut të interesuar	(2)	Konsultim elektronik: publikimi në RENJK	e-mail koordinatori i Konsultimit Publik për MB Besmira Hoxha besmira.hoxha@mb.gov.al . Përgjegjëse Jonarda Qurku jonarda.qurku@mb.gov.al . RENJK
Grupet e interesit Organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, shoqata etj.	(2)	Kontribute dhe komunikime të vazhdueshme përmes takimit/tryezës	Telefoni, email RENJK

2. Afati kohor i aktiviteteve të konsultimit (nga fillimi deri në raportim)

Lista e të gjitha aktiviteteve të parashikuara të konsultimit me datën e përafërt të zbatimit.

Projektakti është hartuar nga Ministria e Brendshme dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore. Draft SNDQV 2022-2030 është hartuar dhe koordinuar nga Ministria e Brendshme dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore me kontributin e Grupit Ndërinstitucional të Punës me përbërje në nivel Zëvendësministri/Drejtor i Përgjithshëm dhe nëngrupeve Teknike të Punës, sipas tematikave/funksioneve të deleguara në nivel specialistësh dhe ekspertësh, të ngritura me urdhrin nr. 76, **datë**

22.04.2022 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore dhe Planit i Veprimit, 2023-2030”.

Janë zhvilluar këto takime:

Data	Takimet e organizuara
25 Mars 2022	Mbledhja e Grupit Tematik të Decentralizimit për hartimin e strategjisë së Re të Decentralizimit, me pjesëmarrjen e partnerëve të zhvillimit dhe donatorëve, të cilët do të mbështesin me ekspertë dhe ekspertizë.
21 Prill 2022	Miratim i vizionit, konceptit dhe afateve kohore të SNDQV 2023-2030 nga Komiteti i Planifikimit Strategjik.
12-13 Qershor 2022	Takim konsultativ me SIGMA-OECD mbi metodologjinë e hartimit të SNDQV-së 2023-2030.
17 Qershor 2022	Konferenca hapëse mbi hartimin e Strategjisë 2023-2030 dhe Planit të Veprimit.
29 Qershor 2022	Takim me kryetarët e bashkive të qarkut Elbasan dhe Shoqatën për Autonomi Vendore.
28-29 Gusht 2022	Seminar mbi rekomandimet e disa funksioneve specifike të njësisë të vetëqeverisjes vendore.
23 Shtator 2022	Takim konsultativ për hartimin e Strategjisë me stafet teknike të bashkive dhe të këshillave bashkiake.
29 Shtator 2022	Takim me Grupin Politik të Punës mbi hartimin e SNDQV-së dhe Planit të Veprimit.

3. Burimet e nevojshme

Përshkruani nr. e stafit të nevojshëm, mjetet financiare dhe teknike të nevojshme etj.

Burime njerëzore të nevojshme:

Në mbështetje të urdhrit nr. 76., datë 22.4.2022 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës dhe të grupit teknik të punës për hartimin e Strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore e të Planit të Veprimit, 2023-2030”, grupi

ndërinstitucional i punës është kryesuar nga zëvendësministri i Brendshëm, përgjegjës për koordinimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore, dhe në përbërje ka këta anëtarë:

- Zëvendësministrin e Financave dhe Ekonomisë, përgjegjës për financat vendore;
- Zëvendësministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Zëvendësministrin e Mbrojtjes;
- Zëvendësministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Zëvendësministrin e Turizmit dhe Mjedisit;
- Zëvendësministrin e Arsimit dhe Sportit;
- Zëvendësministrin e Kulturës;
- Përfaqësues nga ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve;
- Përfaqësues nga kabineti i Zëvendëskryeministrit;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës;
- Drejtorin e Departamentit të Administratës Publike;
- Përfaqësues nga shoqata e përfaqësuesve të vetëqeverisjes vendore.

Refeuar urdhrin të mësipërm të Kryeministrit grupi teknik i punës është drejtuar nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe ka në përbërje përfaqësues, në nivel drejtor i përgjithshëm/drejtor drejtorie/përgjegjës sektori dhe ekspertë, që kanë lidhje me çështje të funksioneve të deleguara të pushtetit vendor nga institucionet e mëposhtme:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Ministria e Kulturës;
- Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve;
- Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;
- Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës;
- Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara;

- Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit;
- Departamentit i Administratës Publike;
- Shkolla Shqiptare e Administratës Publike;
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit;
- Shoqata e Përfaqësuesve të Vetëqeverisjes Vendore;
- Shoqata e Qarqeve.

Gjithashtu:

- Koordinatori për konsultimin në MB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJK.

Burime financiare të nevojshme:

Referuar kreut IX të relacionit shpjegues, kjo strategji financohet nga një sërë burimesh, Qeveria Shqiptare, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe Partnerë Zhvillimi. Në terma të kostimit, Strategjia vjen e shoqëruar me një Plan Veprimi 3 vjeçar (2023-2025) të kostuar sipas standardeve IPSIS dhe metodologjisë së OECD/SIGMA.

Duke qenë se, të gjithë objektivat specifike, përkatësisht 1-6, parashikojnë asistencë teknike, mbështetje të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, studime, vlerësime ligjore dhe teknike të funksioneve të deleguara pushtetit vendor, i gjithë plani i veprimit shoqërohet me kostot indikative sipas zërave përkatëse, të cilat janë të mbështetura edhe në Programin Buxhetor Afatmesëm.

Pajisje të nevojshme:

Laptop, projektor, të siguruar nga institucioni i MB.

4. Mbledhja e përgjigjeve

Përshkruani mënyrën se si mendoni që të mblidhni përgjigjet.

Përgjigjet mblidhen përmes këtyre mënyrave:

- Regjistri RENJK <http://www.konsultimipublik.gov.al>.
- Me komunikime verbale të mbajtura në takime të grupit të punës
- E-mail;
- Telefon.

5. Monitorimi i procesit

Kjo matricë mund t'ju ndihmojë në monitorimin e vazhdueshëm pasi përfshin treguesit dhe metodat më të zakonshme për matjen e nivelit të suksesit të proceseve të konsultimit. Në fazën e planifikimit, ju duhet të përcaktoni vlerën e planifikuar të treguesve sasiorë dhe metodave/mjeteve që do të përdorni për matjen e suksesit gjatë dhe në përfundim të procesit.

Treguesit dhe metodat për monitorimin e procesit				
Korniza e procesit		Përshtatshmëria	Masat për përmirësime (deklaroni, si do të përmirësoni procesin e pjesëmarrjes)	
A u realizuan aktivitetet sipas afatit të planifikuar?		<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo		
A u realizuan aktivitetet sipas burimeve financiare të planifikuara?		<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo		
A u realizuan aktivitetet sipas burimeve njerëzore të planifikuara?		<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo		
Treguesit sasiorë				
Treguesit sasiorë (deklaroni treguesit për monitorim)	Vlerat e planifikuara (deklaroni treguesit për vlerat)	Vlerat e arritura (deklaroni vlerën e arritur)	Përshtatshmëria	Masat për përmirësime (deklaroni si do të përmirësoni performancën)
<i>(plotësojeni gjatë fazës së planifikimit të procesit)</i>		<i>(plotësojeni gjatë monitorimit)</i>		
x <input type="checkbox"/> numri i metodave konsultimit	-RENJK -Tryezë publike -email		<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo	
x <input type="checkbox"/> numri i palëve të përfshira			<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo	
x <input type="checkbox"/> numri i pjesëmarrësve			<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo	
x <input type="checkbox"/> numri i komenteve pranuar			<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo	
<input type="checkbox"/> tjetër:			<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo	
Mjetet për matjen e treguesve				

- lista e pjesëmarrësve
- raportimi i aktivitetit
- raporti i reagimeve
- lista e komenteve të marra
- tjetër:

Treguesit cilësorë

Treguesit cilësorë (zgjidhni treguesit cilësorë - merrni parasysh objektivat e procesit të pjesëmarrjes)	Gjetjet (deklaroni gjetet)	Masat për përmirësime (deklaroni si do të përmirësoni performancën)
<input type="checkbox"/> cilësia e metodave të konsultimit	Ministria synon të vijojë përdorimin e metodave të ndryshme të konsultimit si RENJK, tryezë publike apo email sidomos me qytetarë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të këtij projektvendimi.	
<input type="checkbox"/> përmbushja e pritshmërive të pjesëmarrësve	Përdorimi i sa më shumë metodave të konsultimit do të ndikojë jo vetëm në rritjen e numrit të pjesëmarrësve por dhe në forcimin e rolit që grupet e interesit, shoqëria civile dhe rritjen e numrit të komenteve me qëllim përmirësimin e draftit.	
<input type="checkbox"/> cilësia e komenteve dhe kontributeve të mara	Duke zhvilluar më shumë tryeza konsultimi apo duke përdorur sa më shumë metoda të konsultimit,	

	do të rritet dhe pjesëmarrja e publikut e për pasojë dhe numri i komenteve të përcjella prej tyre.	
<input type="checkbox"/> treguesit sipas objektivave të procesit:		
Mjetet për matjen e treguesve		
<input type="checkbox"/> pyetësi i vlerësimit <input checked="" type="checkbox"/> diskutimi joformal me pjesëmarrësit <input checked="" type="checkbox"/> regjistrimi i pikëpamjeve të pjesëmarrësve <input checked="" type="checkbox"/> raportimi i aktivitetit <input type="checkbox"/> tjetër:		